



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .07.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE, DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shërbim i sigurimit të jetës së punonjësve, sigurim shëndeti nga aksidentet në punë"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 66512000-2 - Shërbime të sigurimeve shëndetsore dhe aksidentale,

VLERA E FONDIT LIMIT: 18,072,189 (tetëmbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me shërbimet objekt i kontratës, leshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), referuar ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Aneks 1 A (klasat 1 dhe 2) dhe B klasa 19.1

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", dhe shërben për të garantuar AK se ofertuesi është i licencuar për kryerjen e këtij aktiviteti në bazë të ligjit Nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Aneks 1 A (klasat 1 dhe 2) dhe B klasa 19.1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.1.2. Licence profesionale për të paktën një person *për ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit në sigurime për dëmet materiale dhe dëmet shëndetësore*, leshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF), referuar VKM Nr 164 Datë 28.01.2008, "*Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime*", shoqeruar me kontrate pune dhe listepagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit që provon se vlerësuesi i dëmeve është i punësuar pranë operatorit ekonomik.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë aftësinë teknike dhe kanë staf të specializuar për vlerësimin e dëmeve dhe ky kriter është në përputhje të plotë dhe proporcional lidhur me kontratën objekt prokurimi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvorjen e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e përvorjes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: